

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË “Albania Engineering Construction” SH.P.K.)

Sot, më datë 14.12.2022 palet me vullnetin e tyre te lire kane nenshkruar kete kontrate te shitblerjes se kuotave te Shoqerise Albania Engineering Construction shpk me Nipt L42021006L dhe me te dhena personifikuese si me poshte,

SHITES:

Z. Aurel Nezhaj, atësia Eqerem, amësia Fatbardha, shtetas Shqiptar, lindur në Dukat,Vlore dhe banues në Tirane, me adresë ne Rr.Shyqyri Brari,Nd. 6 , H.2 Ap.18 , gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038290387 dhe nr. personal I61023034A, që këtu më poshtë, do të përcaktohet si “Shitësi”.
Si dhe

BLERES:

Z. Albert Halilaj , atësia Shkelqim, amësia Gashie, shtetas Shqiptar, lindur në Kukes dhe banues në Tirane, me adresë ne Kodren e Kocit, Farke, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033636365 dhe nr. personal I61115049K që këtu më poshtë do të përcaktohet si “Bleresi”.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord per nenshkrimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Albania engineering Construction” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

TË DHËNA PARAPRAKE

1.1. Z. Aurel Nezhaj eshte pronar me 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Albania Engineering Construction” Sh.p.k, kuota të cilat janë të lira nga çdo pretendim apo barrë në favor të të tretëve.

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj Kontrate Shitje është kalimi i pronësisë, kundrejt shpërblimit, i 50% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Albania Engineering Construction” Shpk, të zotëruara nga ortaku **Z. Aurel Nezhaj**, në favor të Blerësit, **Z. Albert Halilaj**.

NENI 2

Çmimi dhe Pagesa e tij

Çmimi total për shitblerjen e kuotave të kapitalit, do të jetë në masën **2'150'000 Lekë (Dy milion e njeqind e pesedhjetë mije Lekë)** dhe do t'i paguhet Shitësit, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate në numrin e llogarisë së tij. Me nënshkrimin të kësaj Kontrate, Blerësi fiton pronësinë e plotë mbi këto kuota dhe ka të drejtën të depozitojë këtë Kontratë pranë QKB-së për pasqyrimin e kalimit në pronësi të tij të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 3

Taksat dhe Kontributet

Çdo taksë apo tarifë e cila lidhet me kalimin e pronësisë së kuotave apo gjithçka tjetër që lind si rrjedhojë e përbushjes së termave të kësaj Kontrate do të kryhet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

NENI 4

Njoftimet

a. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e kërkuara apo që mund të lindin nga kjo Kontratë do të kryhen me shkrim dhe do të konsiderohen të marra, nëse dorëzohen personalisht apo me email (me verifikim marrjeje), të dërguara me postë (rekomande) Palëve në adresat e mëposhtme, ose adresa të tjera të përcaktuara me shkrim në vazhdimësi:

SHITËSI:

Z. Aurel Nezhaj

e-Mail: aurel.nezhaj@aec.al

BLERËSI:

Z. Albert Halilaj

e-Mail: alberthalilaj22@gmail.com

b. Çdo ndryshim në adresat e specifikuar më sipër duhet të njoftohet në kohë dhe me shkrim palës tjetër, duke përdorur të njëjtat metoda siç janë përcaktuar në këtë nen.

NENI 5

Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet në lidhje me këtë Kontratë, do të paguhet nga Palët në mënyrë të barabartë.

NENI 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

a. Kjo Kontratë do të interpretohet sipas Ligjit Shqiptar. Çfarëdo çështje e cila nuk parashikohet nga kjo Kontratë, do të zgjidhet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

b. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve dhe që ka të bëjë me interpretimin, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate, Palët bien dakort të bëjnë maksimumin e mundshëm për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

c. Nëse pas përpjekjeve të arsyeshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë miqësore, zgjidhja nuk arrihet për 30 (tridhjetë) ditë nga tentativa e parë për zgjidhje miqësore, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në rrugë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 7

Konfidencialiteti

Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të përfshirë në këtë kontratë dhe të mos e kalojnë atë në asnjë formë tek të tretët.

NENI 8

Anekset e Kontratës

a. Sikundër është përcaktuar edhe më lart në këtë Kontratë, Palët kanë detajuar në Anekse të posaçme të dhëna të nevojshme dhe të domosdoshme për qartësimin e Kontratës dhe të vetë marrëdhënies ndërmjet Palëve.

b. Në të tilla kushte, këto Anekse do të jenë pjesë përbërëse dhe e pandashme e Kontratës, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore për Palët ashtu si edhe vetë kjo Kontratë.

c. Anekset e Kontratës janë:

Aneksi 1: Ekstrakt nga QKB i Shoqërisë "Albania Engineering Construction" Shpk, dhe të dhënat identifikuese të palëve.

NENI 9

Të ndryshme

Kjo kontratë është përgatitur në 4 (kater) kopje të njëjta në gjuhën Shqipe, nga një kopje prej të cilave i vendoset në dispozicion Shitësit dhe Blerësit, respektivisht, një kopje depozitohet në regjistrat e QKB-së, një kopje në arkivën e Shoqërisë .

NENI 10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike dhe e nenshkruan atë.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Aurel Nezhaj

Aurel Nezhaj
AN

BLERES

Albert Halilaj

Albert Halilaj

